



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 tetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zgjatje Afati për Dorëzimin
e Njoftimit të Nëntëmbëdhjetë për Dëshirën për të Pyetur Dëshmitarët**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(4)(c) dhe 40(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 tetor 2024 Zyra e Prokurores së Specializuar ("ZPS") dorëzoi listën e dëshmitarëve për periudhën 18 nëntor 2024 deri më 30 janar 2025 ("Parashtrimi i ZPS-së").¹

2. Më 11 tetor 2024, Mbrojtësi i Viktimave dorëzoi kërkesën për zgjatjen e afatit për t'iu përgjigjur Parashtrimi të ZPS-së ("Kërkesa").²

II. PARASHTRIME

3. Mbrojtësi i Viktimave kërkon zgjatje afati me dhjetë (10) ditë deri të premtën, 25 tetor 2024, për të dorëzuar (nëse i kërkohet) njoftimin e tij të nëntëmbëdhjetë për dëshirën për të pyetur dëshmitarët ("Njoftimi i Nëntëmbëdhjetë").³ Mbrojtësi i Viktimave parashtron se është njoftuar për Parashtrimin e ZPS-së më 8 tetor 2024 dhe se, në bazë të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit, Njoftimi i Nëntëmbëdhjetë duhet të dorëzohet brenda shtatë ditësh nga Parashtrimi i ZPS-së, pra deri më 15 tetor 2024.⁴ Mbrojtësi i Viktimave argumenton se, duke mbajtur parasysh vëllimin e materialeve që lidhen me dëshmitarët e njoftuar në Parashtrimin e ZPS-së, numrin e viktimave interesi i të cilëve mund të preket, nevojën e mundshme për

¹ F02620, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrimi i Prokurorisë i Listës së Dëshmitarëve nga 18 nëntori deri më 30 janar 2025*, 7 tetor 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua po në të njëjtën ditë, F02620/RED).

² F02637, Mbrojtësi i Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtësit të Viktimave për Zgjatje Afati për Dorëzimin e Njoftimit të Nëntëmbëdhjetë për Dëshirën për të Pyetur Dëshmitarët*, 11 tetor 2024.

³ Kërkesa, para. 3.

⁴ Kërkesa, para. 2.

t'u konsultuar me ta si dhe angazhime të mëparshme, masa ndreqëse e kërkuar është e domosdoshme dhe e përligjur në këto rrethana.⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej panelit.

IV. DISKUTIM

5. Trupi Gjykues konstaton se Kërkesa është në kohë pasi është dorëzuar në kohë të mjaftueshme para afatit përkatës.

6. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstaton se Mbrojtësi i Viktimave ka demonstruar arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit, duke mbajtur parasysh, veçanërisht: (i) vëllimin e materialit që lidhet me dëshmitarët e njoftuar në Parashtrimin e ZPS-së; (ii) numrin e viktimave interesi i të cilëve mund të preket; dhe (iii) nevojën e mundshme të Mbrojtësit të Viktimave për t'u konsultuar me viktimat që u preken interesat. Trupi Gjykues po ashtu merr parasysh se palët nuk paraqitën kundërshtime për Kërkesën.⁶ Trupi Gjykues gjykon se zgjatja e afatit të kërkuar nga Mbrojtësi i Viktimave është i arsyeshëm dhe proporcional në këto rrethana.

7. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykues miraton Kërkesën dhe zgjat afatin për Mbrojtësin e Viktimave të dorëzojë (nëse kërkohet) Njoftimin e Nëntëmbëdhjetë deri **të premten, 25 tetor 2024, ora 17:00.**

⁵ Kërkesa, para. 3.

⁶ *Shih* Kërkesa, para 3.

V. VENDIM

8. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave; dhe
- b) **ZGJAT** afatin për Mbrojtësin e Viktimave të dorëzojë Njoftimin e Nëntëmbëdhjetë deri të premten, 25 tetor 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 14 tetor 2024

Në Hagë, Holandë